



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME BERAT SH.A
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Berat, më ____ .04.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Pune Publike

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Ndërtim i rrjetit të ujësjetlësit zona Industriale (ish rezervat e shtetit-Ura e Hanit) dhe linjës së dergimit” Berat

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45000000-7 – Punë ndërtimi, 44162500-8 - Tubacione të ujit të pijshëm**

VLERA E FONDIT LIMIT: 170,257,375 (Njëqind e shtatëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqeria Rajonale Ujesjetlës Kanalizime Berat sh.a**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura e prokurimit është deri në kufirin e lartë monetarë.

Në përputhje me nenin 33 të LPP kufijtë monetarë janë:

a) Kufiri i lartë monetarë:

- 650.000.000 (gjashtëqind e pesëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;

- 40.000.000 (Dyzet milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe mallrave.

b) Kufiri i ulët monetarë:

- 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;

- 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Për mbledhës të Vetëdeklarimit , sipas shtojcës 8,

b. Sigurimine Ofertës ,sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM

Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Kërkesat e mësipërme janë detyruese dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomik pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedura prokurimi si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet tatimore dhe ato të energjisë elektrike sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit të ofertës është detyrim ligjor i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi mësipërcituar, si një mjet garancie për AK në rast të tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave, refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2. Ofertuesiduhettëparaqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas përcaktimeve në Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes /Kualifikimit, sipas Shtojcës 7

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, Nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2021, 2022, 2023 të konfirmuara me vule pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmes “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.2 Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3. Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2023 dhe per tremujorin e pare te vitit 2024 (per NIPT-in kryesor dhe per NIPT-et sekondare), ku te përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; ne te gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

Ky kriter te permbushet nepermjet paraqitjes se formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas Shtojces Nr. 8 te DST-së. Ndersa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia / Komuna me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në Shtojcën Nr. 8 të DST-së.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77, pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik ku përcaktohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në :b) **gjendjen ekonomike dhe financiare ;... 3)Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...”**

Në nenin 43“Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021“Përmiratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3(tre) vitet e fundit financiare.”**

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:...b) **vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;**

Nëse vlerësohet, Autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vite te fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Gjithashtu, për caktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i’u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht:

Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton”Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar nëudhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin

deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave zbatim të këtij ligji.

Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar pika 3.12 etij, dhe kërkesave të **Ligjit Nr.25 datë 10.05.2018** "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 9 i tij ku parashikohet: "Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përjashtimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financat".

Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike" gjykojmë që të kërkojmë xhiron vjetore dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2021,2022,2023) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Gjithashtu komisioni kërkoi edhe pagesat e taksave vendore bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (të ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këtotë fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Komisioni përcaktoi kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qënë se këto kritere janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre përpërbushjen me sukses të kontratës.

❖ **Kriteret e kapacitetit teknik të mëposhtme nga pika 2.3.1 deri në pikën 2.4.5, janë hartuar dhe argumentuar nga specialistët e fushës, të cilët janë pjesë përbërse e njësisë së prokurimit të procedurës, duke u administruar në dosjen e procedurës së prokurimit, procesverbalit të hartimit dhe argumentimit të kriterëve të kapacitetit teknik i nënshkruar, nga to në zbatim të dispozitave ligjore të parashikuara në pikën 2 të nenit 74 dhe në pikën 2 të nenit 78 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik e ndryshuar, si dhe njoftimit Nr. 4916/2 prot, datë 14.07.2022, pika 1, të Agjencisë së Prokurimit Publik "Mbi organizimin e Procedurave të Prokurimit Publik".**

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin:

- a) dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, (te natyrës së ngjashme sipas preventivit).

Ose

- b) dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*), (te natyrës së ngjashme sipas preventivit).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë kontratën, formular vlerësimi lëshuar nga Investitori sipas Shtojcës 9 dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi të përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vertetime të shoqëruara me faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat, natyra e punës së kryer dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar).

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i Bashkimit të Operatoreve.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor dhe kontrates midis Kontraktorit dhe nënkontraktorit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” kupërcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike , si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore , në veçanti , mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: “ Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet .**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipër përmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme , kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik , për përmbushjen me sukses të kontratës , ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës , ku të shënohen vlera , afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë , e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor , përveç kërkesa vetë parashikuara në këtë nen , mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta , në varësi të objektit që prokurohet , të cilat vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Komisioni përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme , janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Sipas këtij neni, Komisioni vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentacioneve ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe akte venë zbatim të tij , pasi duke qenë se kontrata për punë publike që prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin dhe situacionet përfundimtare si dhe formular vlerësimi për punët e kryera

me entet publike, për të patur mundësi të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punime të mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë Autoritetet Kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Meqenëse se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk kanevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), Komisioni gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar, në përputhje me zërat e punimeve që përfshihen në preventivin e punimeve, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- | | |
|--|----------------------|
| • Kategoria NP- 1 Punime germimi ne toke | Klasifikimi B |
| • Kategoria NP- 2 Ndërtime civile dhe industriale | Klasifikimi A |
| • Kategoria NP- 7 Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje | Klasifikimi D |
| • Kategoria NP- 12 Punime te Inxhinierise se Mjedisit | Klasifikimi A |
| • Kategoria NS- 4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, | Klasifikimi A |
| • Kategoria NS- 8 Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura | Klasifikimi A |
| • Kategoria NS-14 Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni Tv, etj | Klasifikimi A |
| • Kategoria NS-18 Punime topogjeodezike | Klasifikimi A |

Në rastet e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera / Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehsimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s`kualifikue

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i

përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burime te nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”.

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike ” pika 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” përcaktohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a)**licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve,objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore ;”

VKM Nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi ” (lidhja 2,3 dhe 4).

Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”(të ndryshuar), dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi ”, komisioni vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në licencën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës.

Konkretisht llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre , sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

Sipas VKM Nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar:

Kategoria N.P-1“ B Punime gërmimi në tokë ”Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale , argjilore , ranore , zhavorrishte ose shkëmbore.

Kjo kategori është kërkuar duke patur parasysh se parashikohen në preventiv punimet gërmim dheu me krah dhe makineri, mbushje, ngjeshje, sistemim të tokës etj, proceset te cilat do të kryhen me qellim shtrimin e tubacioneve të linjës kryesore dhe ate të shpërndarjes . Në preventiv janë parashikuar në total volume dhera të gërmuara, të cilat konkretisht karakterizohen nga gërmim dheu me eskavator me goma, etj. Më tej ajo mbulon të gjitha punimet që lidhen me konstruksionin e prerjeve , largimin e materialeve të papërshtatshme në hedhurina. Këto procese janë të parashikuara në preventiv dhe në specifikimet teknike të publikuara në SPE.

Përcaktimi i nivelit “B” të kësaj kategorie është bërë në bazë të Lidhjes 4, të VKM në fjalë, sipas të cilës, për punime në vlerën 21 deri 50 milionë lekë, nevojitet niveli “B”.

Kategoria N.P - 2 A *Ndërtime civile e industriale.*

Me punime të tilla, referuar VKM Nr.42 të datës 16.01.2008 konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderur, betonim të tavanëve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

Vendosja si kriter teknik i kësaj license lidhet ngushtë me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij projekti. Kjo kategori është kërkuar duke patur parasysh punime për ndërtim pustash, ndërtim mikrotuneli struktura monolite betoni, etj

Në total vlerat për realizimin dhe kompletimin me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese i përcaktojnë të tilla punime në kategorinë A sipas VKM Nr.42 të datës 16.01.2008, të ndryshuar për punime në vlerën 0 deri 20 milionë lekë, nevojitet niveli "A"

Kategoria N.P-7 D *"Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje"*

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar, **ujësjellsat, impiant pompimi, rikonstruksion depo uji, rrjetin shpërndarës** deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve.

Kjo kategori licence i referohet së pari **objektit të kontratës** dhe së dyti punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht furnizim vendosje tuba PE D=40mm/D50/D63/D90/D110/D125/D400/D25/D32 dhe HDPE, puseta kontrolli, tuba celiku, furnizim vendosje tuba dhe rakorderi ujësjellësi etj. Përcaktimi i nivelit "D" të kësaj kategorie është bërë në bazë të Lidhjes 4, të VKM në fjalë, sipastë cilës, për punime në vlerën 101 deri 200 milionë lekë, nevojitet niveli "D".

Kategoria NP-12 "A" *Punime të inxhinierisë së mjedisit.*

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimet të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekulibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpatëve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve

rrugore, hekurudhor të karierave dhe mbetjeve inerte.

Kjo kategori license është vendosur duke patur parasysh se punimet duhet të kryhen me kujdes për të mos prishur strukturën e tokës, rehabilitimi i tokës do të kryhet pas punimeve të ndërtimit si edhe depozitimi i mbetjeve nga gërmimet apo prishjet në vendodhjet e percaktuara. Efektet kryesore në mjedis nga punimet për ndërtimin e një objekti, konsistojnë në vija të pergjithshme si më poshtë: a) emetimet në ajër dhe zhurmat, b) shkarkimet në ujë, ndikimi në tokë, c) ndikimi në florë/faunë, ç) mbetjet e prodhuara d) ndikime social-ekonomike, dh) ndikim në cilësinë e jetës në komunitetin përreth e) ndikim në rritjen e trafikut rrugor, ë) ndikim në peizazhin e zones, h) ndikim në ndryshimet klimatike etj. Përcaktimi i nivelit “A” të kësaj kategorie është bërë në bazë të Lidhjes 4, të VKM në fjalë, sipas të cilës, për punime në vlerën 0 deri 20 milionë lekë, nevojitet niveli “A”

N.S - 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar me punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Vendosja e këtij kriteri u referohet punimeve të parashikuara në projektet teknike, relacionet teknike, specifikimet, preventivin dhe grafikun e punimeve për zbatimin e veprës. Këto punime parqiten të detajuara në projektin arkitekturor dhe specifikimet e punimeve ndërtimore. Punimet e parashikuara në këtë dokumentacion teknik përfshijnë punime murature, dhe punime të ndryshme izolimi. Vëllimi dhe vlerat e punimeve të tilla janë të konsiderueshme. Për zbatimin e punimeve të tilla, VKM Nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar, përcakton se duhet të disponohet licenca NS-4.

Nga sa më sipër, duke marrë në analizë të gjithë dokumentacionin teknik, specifikën e punimeve dhe vlerat e të gjithë punimeve të tilla në preventivin total të kësaj ndërhyrjeje, u vendos si kriter teknik profesional licenca NS-4 A, e cila është e domosdoshme për vlerën, rëndësinë dhe kompleksitetin e punimeve të tilla. Përcaktimi i nivelit “A” të kësaj kategorie është bërë në bazë të Lidhjes 4, të VKM në fjalë, sipas të cilës, për punime në vlerën 0 deri 20 milionë lekë, nevojitet niveli “A”

N.S - 8 a. A Ndërtime parafabrikat betonarme

a. Përfshin Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në veper të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar normal dhe të parandëruar .

Vendosja e këtij kriteri u referohet punimeve të parashikuara në projektet teknike, relacionet teknike, specifikimet, preventivin dhe grafikun e punimeve për zbatimin e veprës. Këto punime parqiten të

detajuara në projektin strukturor Për zbatimin e punimeve të tilla, VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar, përcakton se duhet të disponohet licenca NS-8. Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv, si struktura monolite betoni per puseta etj

Nga sa më sipër, duke marrë në analizë të gjithë dokumentacionin teknik, specifikën e punimeve dhe vlerat e të gjithë punimeve të tilla në preventivin total të kësaj ndërhyrjeje, u vendos si kriter teknik profesional licenca NS-8 A, e cila është e domosdoshme për vlerën, rëndësinë dhe kompleksitetin e punimeve të tilla. Përcaktimi i nivelit “A” të kësaj kategorie është bërë në bazë të Lidhjes 4, të VKM në fjalë, sipas të cilës, për punime në vlerën 0 deri 20 milionë lekë, nevojitet niveli “A

Kategoria NS-14A *Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni Tv, etj* eshte kerkuar pasi: Kjo kategori licence i referohet punimeve elektrike te cilat jane te domosdoshme dhe pasqyrohen ne preventiv me realizimin e ndricimit te depove, furnizim vendosje ndricues floreshent, elektroda tokezimi,prozhektor,lidhjet me sistemin e SCADA me sallen e informacionitetj, punime te cilat jane pjese e pandare e rikonstruksion te dhomes se komandimit Përcaktimi i nivelit “A” të kësaj kategorie është bërë në bazë të Lidhjes 4, të VKM në fjalë, sipas të cilës, për punime në vlerën 0 deri 20 milionë lekë, nevojitet niveli “A

Kategoria NS 18A *Punime topogjeodezike.* Kjo pikë licence përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin erilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike etj. Gjithashtu është vendosur në përputhje me punimet që do të realizohen bazuar nëprojektinezbatimitdhenepreventivinepunimeve. Sikurse shtjellohet në specifikimet teknike të punimeve, mbështetur në dokumentacionin topografik të hartuar nga projektuesi dhe dokumentacionin e objektit, Kontraktori duhet të kryejë transferimin e pikave referenciale dhe gjurmës së objektit në terren, si dhe çdo shërbim tjetër topografik, të nevojshëm për zbatimin e saktë të projektit.

Konkretisht kjo kategori licence është e domosdoshme për piktetimet e kanaleve qe do të germohen dhe sistemimeve topografike. Zbatimi jo i saktë i të projektit në të gjitha nivelet mund të çojë në dëme kolosale dhe pamundësi teknike për realizimin e duhur të këtij konstruksioni.

Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategoritë respektive është kërkuar bazur në zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave te kufijve të parashikuara në VKM Nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar. Përcaktimi i nivelit “A” të kësaj kategorie është bërë në bazë të Lidhjes 4, të VKM në fjalë, sipas të cilës, për punime në vlerën 0 deri 20 milionë lekë, nevojitet niveli “A

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P-1. C	Punime gjermimi në tokë	<ul style="list-style-type: none"> - Germim me krahe seksion detyruar me gjerësi $b > 1$ m, $h=1.5$ m, toke e zak. - Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m^3, ne kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke - Germim gropa sip. $10-30 \text{ m}^2$, toke e zak. me $h = 1.5$ m per puestat - Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m^3, ne kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet 	51-100 mln leke	51.546.440
N.P-2 A	Ndertime civile dhe industriale	<ul style="list-style-type: none"> - Ndertim Mikrotuneli me te gjitha aksesoret per kalimin e rruges me tubacion celiku DN450, L=20m - Prishje shtresa betoni - Prishje shtresa trotuari - Prishje shtresa asfalti - Mbushje, rafshim, ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke zak (material te seleksionuar) - Shtrese rere (nen dhe siper tubit) - Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka - Punime te brendshme ndertimore 	0-20 mln leke	391.996
N.P-7 D	Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje	<ul style="list-style-type: none"> -F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE $d=40\text{mm}$, $t = 3.0$ mm, PN 10 -F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE $d=50\text{mm}$, $t = 3.7$ mm, PN 10 -F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE $d=63\text{mm}$, $t = 4.7$ mm, PN 10 -F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE $d=75\text{mm}$, $t = 5.6$ mm, PN 10 -F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE $d=315\text{mm}$, $t = 23.2$ mm, PN 10 	21-50 mln leke	105.600.487
N.P-12 A	Punime të inxhinerisë së	<ul style="list-style-type: none"> - Prerje bime te vogla $\varnothing-10\text{cm}$ - Mbushje me cakell e gur gurore $t=20\text{cm}$ mbi 	0-20 mln leke	42.165

	mjedisit	tombinon e betonit (pa rulum)		
N.S-4. A	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifinitura me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese	<ul style="list-style-type: none"> - Prishje suvatim nga brenda mure - Prishje suvatim solete - Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25 - Hidroizolim muri perimetral i salles se komandimit me 2 shtresa material bikomponent 	101-200 mln leke	499.578
N.S – 8 A	Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri	<ul style="list-style-type: none"> - Konstruksione metalike te thjeshta (zgara metalike ne dysHEME+ shkall - F.V dyer metalike me llamarine te zeze me 1/2 grile (Bodrumi) - Puse kontrolli 1.25x1.25x1,5m 	21-50 mln leke	201.203
N.S – 14 A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.	<ul style="list-style-type: none"> - Fv.percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2 - Fv.percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2 - F.V percjelles PV-500 Ø 6 mm2 - Prozhektor - Ndricules fluoreshent 2x36w,IP40 - F.V Çelesa e priza 10 A 	0-20 mln leke	31964
N.S-18. A	Punime topogjeodezike	RILEVIM TOPOGRAFIK, Ne referim termat e references	0-20 In leke	

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës si dhe punonjësit specialistë me certifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatori Ekonomik duhet të ketë te punësuar mesatarisht të paktën **73 (Shtatëdhjetë e tre)** punonjes për periudhene muaj Mars 2024.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës Nr.8. Ndersa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve te ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet te dorezoje dokumentacionin:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku te specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesiperme.

- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, te paraqitura dhe tekonfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme.

b) Operatori Ekonomik duhet te kete të punësuar për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt,

Drejtuesit Teknik si me poshte:

- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet / Topograf 1 (një)
- Inxhinier Mjedisi 1 (një)

Drejtuesit Teknik te jene te përfshirë në liçencën e shoqërisë, të figurojnë në listëpagesa për muajn Mars 2024, te kene kontrate pune te vlefshme, të deklarojne se nuk jane te angazhuar në kontrata të tjera dhe se do të jenë te pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Operatori Ekonomik, permbushjen e ketij kriteri duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë nga administratori i shoqërisë per personelin kryesor, Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi te rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas Shtojcës Nr.8. Ndersa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve te ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, per Drejtuesit Teknik duhet te dorezoje dokumentacionin:

- Kontratë pune e vlefshme gjate gjithë kohes se zbatimit te punimeve objekt kontrate
- Diplomë profesionale
- CV
- Libreze pune

c) Operatori Ekonomik per te realizuar objektin e prokurimit, duhet të ketë te punesuar per kryerjen e te gjithapunimeve ne objekt, jo domosdoshmerisht te perfshire ne licensen e shoqërisë, stafin inxhinierik si me poshte:

- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas Shtojcës Nr.8. Ndersa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve te ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, per stafin e inxhinierëve te sipercituar, duhet te dorezoje dokumentacionin:

- Kontratë pune e vlefshme gjate gjithë kohes se zbatimit te punimeve objekt kontrate;
- Diplomë profesionale;
- Libreze pune;

d. Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar stafin teknik te perbere nga te pakten **27 (Njezetë e shtate)** punonjes te specializuar dhe te certifikuar sipas profesionit qe kryejne dhe te pasqyruar ne liste pagesat eshoqërisë për periudhën muaj Mars 2024, me profesione si me poshte:

- **5 (pese) hidraulike**, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe dëshmi kualifikimi IQT/certifikate.
- **2 (dy) specialist ndertimi (teknik ndertimi)**, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe dëshmi kualifikimi IQT/certifikate.
- **1 (nje) saldatore**, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme .
- **1 (nje) specialiste elektriciste**, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe dëshmi kualifikimi IQT/certifikate.
- **1 (nje) mekanike**, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe dëshmi kualifikimi IQT/certifikate.
- **1 (nje) specialiste karpentier** shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe dëshmi kualifikimi IQT/certifikate.
- **2 (dy) specialist hidroizolues** shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe dëshmi kualifikimi IQT/certifikate.
- **2 (dy) hekurkthyes** shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe dëshmi kualifikimi IQT/certifikate.
- **1 (nj) bojaxhi** shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme.
- **6 (gjashte) shofere** për drejtimin e mjeteve kamiona, shoqëruar me kontratë pune te vlefshme dhe leje drejtimi me kategorine "C" dhe/ose "CE" dhe/ose "D" dhe/ose "DE" leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimit te Transportit Rrugor.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates sipas Shtojcës Nr.8. Ndersa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve te ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, duhet te dorezoje dokumentacionin si me poshte:

- Kontratë pune e vlefshme gjate gjithë kohes se zbatimit te punimeve objekt kontrate.
- Per specialistet e mesiperm (me perjashtim te punonjesve bojaxhi dhe shofere) te paraqiten Kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme te lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve sipas parashikimeve te Ligjit Nr.8734 datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

e. Operatori Ekonomik duhet te kete te pakten :

- 6 (gjashtë) Manovratore / Eskavatoriste / Automakinist

Te cilet mund te jene pjese e stafit ose te kontraktuar me kontrate pune / shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri ne perfundimin e kontrates.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates sipas Shtojcës Nr.8. Ndersa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve te ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet te dorezoje dokumentacionin:

- Deshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimit te Transportit Rrugor;
- Kontrate pune / sherbimi te vlefshme;
- Kartele personale e sigurimit teknik të vlefshme te lëshuara te lëshuara nga institucione shteterore ose nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve.

f. Operatori Ekonomik duhet te kete te pakten :

- 1 (një) punonjes te certifikuar me deshmi trajnimi si “Pergjegjes per sigurimin teknik dhe shendetin ne pune” te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, kerkese kjo ne perputhje me Ligjin Nr.10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe V.K.M Nr. 312 date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier". Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 te VKM Nr.285 date 19.05.2021 secili prej operatorëve ekonomike duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1(një) "Pergjegjes per sigurimin teknik dhe shendetin ne pune", sipas zerave te punimeve / sherbimeve / mallit qe do te marre persiper te realizoje sipas akt marrevshjes / kontrates se bashkepunimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe /ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje për muajin e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 72 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM Nr. 631, datë 26.10.2018), për përcaktimin e numrit të punonjësve është bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës që duhen për të përmbushur kontratën, nga ku për çdo zë të preventivit janë marë orët e punës për njësi, duke i shumëzuar me volumet për çdo zë, dhe duke nxjerrë orët e punës të nevojshme për realizimin e këtyre zërave. Nevoja për orë pune është përkthyer në ditë pune dhe duke marrë në konsideratë periudhën e realizimit të përcaktuar në grafikun e punimeve ka dalë numri i punonjësve i nevojshëm.

Për sa më sipër sqarohet se: Konkretisht për kryerjen e punimeve në total kemi 154803 orë pune. Bazuar në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, nëni 78, pikë 1, ku kohëzgjatja ditore normale e punës është jo më shumë se 8 orë, kemi 19,350 ditë pune. Grafiku i punimeve është përlogaritur që punimet të kryhen për një periudhë 12 mujore ose 264 ditë (bazuar po në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë). Si përfundim për të realizuar punimet në 264 ditë sipas grafikut, ku në analizen teknike sipas zërave janë 19,350 ditë shtuar këtu edhe specialistet e fushës duhen afërsisht 73 punonjës.

Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 73 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe afatet të cilat do të kryhen punimet duke qenë në zbatim të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, që çdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

Gjithashtu, me qëllim ndërtimit të objektit të vepres sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, duke qënë se vlera e preventivuar për punimet që do të kryhen është mbi 30,000,000 milion në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, të përfshirë në liçensimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Drejtuesi teknik duhet të

disponoje kualifikimet e kërkuara, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Në përlogaritjen e numrit të punonjësve, njesia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentat e tenderit, prej periudhën 12 muaj , ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatumor, janë përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlogaritjen e numrit të punonjësve përfshihen punonjësit inxhinierë, specialiste, punonjës të kualifikuar dhe punetore për punime me krahe, (total janë parashikuar rreth 200 m³ germime me krahe), drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të renda etj, duke patur parasysh njekohesisht volumin e lartë të punimeve. Duke qenë se ky objekt përfshin ndërtimin e linjes kryesore të ujesjellesit dhe rrjetin shpërndarës të tij si dhe duke u bazuar në grafikun dhe llojin e punimeve që do të kryhen si: ndërtim i linjes kryesore dhe linjes së shpërndarjes, germime, ngjeshje, sistemime, hidroizolime, rrethim kaptazhi, shtrim tubacionesh, rikonstruksion depo, rikonstruksion dhomë së komandimit, pusetat shpërndarëse, pusetat e ajrimit, shkarkimit dhe kontrollit, punimet me krahe, mbushje etj, punime këto të cilat duhet të realizohen brenda afatit të parashikuar të objektit në grafikun e punimeve, gjithsej 12 muaj, lind nevoja për këto fuqi të përcaktuara punetore. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, njesia e prokurimit referuar zërave të punimeve që do të kryhen objekt kontrate, vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara. Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës që i është bërë preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik), ku më hollësisht parashtrahet:

Eshte kerkuar **inxhinier hidroteknik** i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve voluminoze hidraulike lidhur me zërat e preventivave të punimeve seksioni “Punime hidroteknike”, kontrollin e gjithë punimeve që kanë lidhje me ndertimin e linjes kryesore dhe linjave të shperndarjes, rrethim i kaptazhit, punime për linje dergimi nga burimi neper depo, furnizim vendosjen e tubacioneve dhe rakorderive të ujesjellesit pergjate gjithë rrjetit etj.

Eshte kerkuar **inxhinier ndërtimi** i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivave të punimeve, kontrollit të punimeve të betonit të pranishme në preventiv si: ndertim mure betoni, pusetat beton arme, puseta ajrimi, puseta shperndarje dhe pusetat e kontrollit, riparim i depove, etj.

Eshte kerkuar **inxhinier gjeodet/topograf** pasi sipas relacionit teknik dhe specifikimeve teknike eshte parashikuar: “Sipermarresi, me shpenzimet e tij duhet të bëjë ndertimin e modinave dhe të piketave sic kerkohet, në përputhje me informacionin baze të Punedhenesit, dhe do të jetë përgjegjës i vetëm për perpikmerine. Sipermarresi do të jetë përgjegjës për të kontrolluar dhe verifikuar informacionin baze që është dhënë dhe në asnjë mënyrë nuk do të lehtësohet nga përgjegjësia e tij nëse një informacion i tillë është i mangët, jo autentik ose jo korrekt. Sipermarresi do të furnizojë dhe mirëmbaje me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale të tjera të tilla dhe të japë asistencë nepermjet një stafi të kualifikuar sic mund të kerkohet nga Punedhenesi për kontrollin e modinave dhe piketave. Sipermarresi do të ruajë të gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, të bera ose të vendosura gjatë punës, të mbulojë koston e rivendosjes së tyre nëse ato demtohen dhe të mbulojë të gjitha shpenzimet për ndreqjen e punës së bërë jo mirë për shkak të mosmirëmbajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim të këtyre pikave të vendosura, modinave dhe piketave”

Eshte kerkuar **inxhinier mekanik** pasi është përgjegjës për punimet mekanike që janë parashikuar në këtë projekt preventiv si proceset e montimit të rakorderive të gizes, montimin e pajisjeve dhe instalimet mekanike. Është e rëndësishme që gjatë realizimit të proceseve të punës për shtrirjen e tubacioneve të asistohen nga personel mekanik duke qenë që këto tubacione kanë diametër dhe peshë të konsiderueshme.

Është kërkuar minimuni **Inxhinier Mjedis** referuar preventivi të Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar **NP 12 A** është e nevojshme prezenca e Inxhinierit të Mjedisit i cili do të bëjë mbikqyrjen e vazhdueshme të ndikimit në mjedis që ka zbatimi i punimeve objekt kontrate.

Eshte kerkuar **inxhinieri elektrik** pasi ka kualifikimin e nevojshëm dhe tagrin për realizimin e skemave të rrjeteve elektrike dhe do të garantojë për realizimin sa më të saktë teknikisht të këtij grupi punimesh të objektit. Janë parashikuar punime elektrike të cilat pasqyrohen në preventiv me realizimin e ndricimit të depove, furnizim vendosje ndricues, etj, punime të cilat janë pjesë e pandare e rikonstruksion të depove. Inxhinieri elektrik ka kualifikimin e nevojshëm dhe

tagrin per realizimin e skemave te rrjeteve elektrike dhe do te garantoje per realizimin sa me te sakte teknikisht te ketyre punimeve.

Gjithashtu, jane përcaktuar kërkesat minimale për punonjësit e kualifikuar që duhet të disponojnë operatorët ekonomikë ofertues për realizimin e ketij objekti. Jane kerkuar punonjes te specializuar dhe te certifikuar me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën;

Konkretisht jane kerkuar:

- **Hidraulike**, te cilet sic parashtruam me lart jane te nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e te gjitha punimeve hidraulike,duke qene se te gjitha punimet ne rrjetin shperndares jane parashikuar me ngjitje elektrofuzivve hidrauliket duhet te jene specialiste te mirefillet ne ngjitjen e elektrofuzive te tubove dhe rakorderive sipas zërave të preventivit të punimeve ku punimet hidraulike zene pjesen me te konsidderueshme te punimeve te kontrates. Konkretisht: Ne specifikimet teknike parashikohet: Valvolat e kontrollit dhe te komandimit duhet te instalohen me ane te bashkimit me fllanxha metalike, guarnicionet plastike perkatese, bullonat dhe vidat duke perdorur pajisjet perkatese te bashkimit te tyre. Ky lloj bashkimi duhet te garantoje nje lidhje te sigurte, homogjene dhe jetegjate. Cilesia e Instalimit varet ne nje mase te madhe nga personeli qe do te beje kete ngjitje dhe respektimi prej tyre i kerkesave teknike. Per kete arsye, specialistet qe do te punojne per bashkimin e tyre duhet te jene te pajisur me certifikaten perkatese per punimet hidraulike e cila do te vertetoje kualifikimin dhe trajnimin e tyre. Si dhe: “Matesat, Instalimi dhe Testimi Cilesia e Instalimit varet ne nje mase te madhe nga presoneli qe do te beje kete instalim dhe respektimi prej tyre i kerkesave teknike. Per kete arsye, specialistet qe do te punojne per instalimin e tyre duhet te jene te pajisur me certifikaten perkatese per punimet hidraulike e cila do te vertetoje kualifikimin dhe trajnimin e tyre”;

- Per kerkesen per specialiste **electriciste** njesia e prokurimit eshte bazuar ne punimet elektrike dhe te ndricimit qe do behen sidomos ne depot me volume te ndryshme, referuar zerave perkates te preventivit.

- Specialistet **hidroizolues** jane kerkuar duke patur parasysh volumin e madh te hidroizolimit ne procesin e kaptazhit dhe ne hidroizolimn e shtreses se poshtme te tyre. Gjithashtu ata do te marrin pjese edhe ne procesin e hidroizolimit te depove, pusetave te ajrimit, shkarkimit etj.

- Specialistet **karpentier** jane kerkuar per te realizuar punimet e armaturave ne beton duke patur parasysh volumin e madh te punimeve me hekur beton (referuar preventivit).

- Specialist **ndertimi**, te cilet jane te nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndertimit, duke patur parasysh punime ndertimore qe do te kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve, dhome klorifikimi, suvatime, lluster etj.
- Punonjesit **saldatore** jane kerkuar per kryerjen e te gjitha punimeve qe kane te bejne me rrjetin e ujesjellesit, montimin e tubave dhe rakorderive te linjes kryesore dhe te shperndarjes. Keto percaktime jane bere edhe ne specifikimet teknike te publikuara ne SPE.
- Punonjes **hekurkthyes** jane kerkuar per te realizuar kthimet e hekurit, kornizat e hekurit ne armaturat e betonit ne punimet e betonit. Keta punonjes realizojne kthimet e hekurit, kornizat e hekurit ne armaturat e betonit ne punimet e betonit dhe shtrese betoni. Specialistet hekurkthyes presin, përkulin dhe vendosin rrjeta teli në strukturat e betonit, bejne planet e punës në lidhje me strukturat e hekurit dhe betonit, përgatitin shufra çeliku ose rrjeta çeliku me gjatësinë e kërkuar duke i prerë ato me mjetet perkatese, mbledhin shufrat ose rrjetat përforcuese duke salduar, instaluar në tokë ose prerë në vende të paracaktuara brenda betonit, fabrikojne struktura çeliku dhe vendosja e tyre si strukturë për derdhjet e betonit, etj.
- Punonjesit **mekanike** jane kerkuar pasi është e rëndesishme që gjatë realizimit të proceseve të punës për shtrirjen e rrjetit kryesor dhe te shperndarjes të asistohen nga personel mekanik duke qenë që tubat kane diametër dhe peshë të konsiderueshme. Gjithashtu këta punonjes do të jenë përgjegjës për ecurinë e mjeteve të gërmimit, të transportit etj, të cilat do të përdoren për punimet e këtij objekti.
- Eshte kerkuar 1 (një) punonjes te certifikuar me deshmi trajnimi si “Pergjegjes per sigurimin teknik dhe shendetin ne pune”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit.

Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

g. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit

ekonomik ofertues minimumi për muajn Mars 2024, ose duhet të paraqitet një kontratë e vlefshme për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të licencuar, sipas ligjit. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili nga operatorët ekonomikë duhet ta plotësojë këtë kusht në përputhje me numrin respektiv të punonjësve sipas kërkesave ligjore.

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është percaktuar bazuar në nenin 3, pika 3, të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik", Ligjin Nr.10237, datë 18.2.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" (i ndryshuar), VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 "Per masat e vecanta te sigurimit dhe te mbrojtjes se shenderit ne pune" (i ndryshuar) i cili percakton "2/1. Ponedhenesi siguron funksionimin e sherbit mjekesor, nepermjet mjekut te ndermarrjes, ne te gjitha subjektet qe ushtrojne veprimtari prodhuese, private ose shteterore, vendase ose te huaja, juridike ose fizike dhe12/2. Per subjektet qe nuk perfshihen ne piken 12/1 te ketij vendimi, marrja ne pune e mjekut te ndermarrjes eshte e detyrueshme per ato ndermarrje, ku numri i te punesnarve eshte jo me pak se 15 punonjes ... Mjeku i ndermarrjes ofron keshillimin e tij per problemet e mbrojtjes ne pune, per shmangien e aksidenteve dhe te semundjeve profesionale, si dhe per te gjitha ceshtjet e mbrojtjes se shendetit dhe sigurise ne pune. Ai vlereson ceshtje te fiziologjise se punes, te problemeve higjienike e sanitare, vecanerisht te ritmit e te kohes se punes, te organizimit te vendit te punes, te zhvillimit dhe te mjediseve te punes.

Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar një numër prej 73 punonjësish për realizimin e kontratës objekt prokurimi. Rrjedhimisht kërkesa e AK që Oe të ketë të punësuar një mjek të përgjithshëm, është në përputhje me nenin 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë", i ndryshuar.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë:

a) Në përputhje me kërkesat dhe dimensionet e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe projekt preventiv, për materialet hidraulike:

- Tuba dhe Rakorderi ujesjellesi HDPE PN10 deri në PN20
- Saracineska
- Rakorderi gize

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

1. Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributor i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-

distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave nenshkruar jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i perkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

2. Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. **Shënim:** Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë të katalogut, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.
3. Të gjitha materialet e mësipërme duhet të jenë sipas Standarteve Europiane. Për Tubat HDPE, dhe saracineskat, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetedeklarim që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësive të prodhuesit / ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetedeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.

- **Per aparatet ujemates:**

- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetedeklarim që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësive të prodhuesit / ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetedeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.
- Operatori Ekonomik të paraqesë certifikate ose deklarate nga prodhuesi / distributori, që vërteton se standarti i prodhimit është sipas OIML R49 sipas rekomandimeve të Organizatës Internacionale të Metrologjisë Ligjore.
- Operatori Ekonomik të paraqesë certifikatën e aprovimit sipas MID / ekuivalente me të sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9875 datë 14.02.2008 të ndryshuar me Ligjin Nr. 10217 datë 21.01.2010, Ligjin Nr.14/2013 dhe Ligjin Nr. 100/2015.

Keto certifikata të jenë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur keto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtori.

Argumentimi: Paraqitja e këtyre dokumenteve është vlerësuar nga njesia e prokurimit pasi duke qenë se në objektin e prokurimit kemi të bëjmë me blerjen e materialeve dhe pajisjeve që do të vendosen në punimet objekt kontrate, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nën 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duhet që këto materiale e pajisje të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: *Autorizim prodhuesi ose distributorin, katalogët ose pjesë të tyre, dëshmitë e testimet të kryera, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.*

Per matesat e ujit eshte kerkuar **certifikimi ISO** sipas referimeve ne **specifikimet teknike** ku

perckatohet *“Matesat e ujit duhet te plotesojne standartet teknike te valvolave dhe te saraçineskave te sistemit **ISO testandarteve**. Ato duhet te sigurojne hermeticitetin ne qarkullimin e ujit, presionin 16 bar te rrjetit. Duhette plotesojne kerkesat e garancise teknike te prodhuesit...”*

Ne lidhje me kerkesen per disponim te ”Certifikaten e aprovimit sipas MID / ekuivalente me te”

Per vendosjen e ketij kriteri, Njesia e prokurimit eshte bazuar ne specifikimet teknike ku percaktohet *“Tegjithe matesit duhet te kene miratimin dhe deklaraten e konformitetit MID. Miratimin per uje te pijshem nga nje organ i njohur nderkombetarisht”*;

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqese certifikatat e cilësisë së punimeve, per objektin qe prokurohet, sipas standardeve:

- Certificate ISO 9001 - 2015 “Per Sistemin e menaxhimit te cilesise”, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.
- Certificate ISO 14001-2015 “Per sistemin e menaxhimit te mjedisit”, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.
- Certificate ISO 45001-2018 “Per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune”, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.
- Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj, ato te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqipe. Keto certifikata te jene leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikatat e mesiperme sipas natyres se punimeve qe do te marre persiper te realizoje, referuar kontrates se bashkepunimit te nenshkruar.

Argumentimi:Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet:“Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**,si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në nenin 44“Kërkesat e cilësisë”të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet:“Autoriteti/entikontraktor,për të vërtetuar se punët,mallrat ose shërbimet,objekt prokurimi,i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata të lëshuara** nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë,vetëm nëse ato janë të argumentuar dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektine prokurimit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë,standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standarde te menaxhimit të mjedisit.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nën ligjore të sipërcituara,Autoriteti Kontraktor vlerëson se: Autoriteti Kontraktor gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesa te standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen,jane kërkuar çertifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime.

Komisioni përcaktoi kriteret si më lart duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë Autoritetit tonë Kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale,organizative,reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Konkretisht **Certifikatë ISO 9001 - 2015** “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi e cila mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive,sigurimin e konkurrencës përpersonelin e shoqërisë,mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës,etj.

Certifikatë ISO 45001-2018 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë” mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës,zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Certifikatë ISO 14001-2015 “Për sistemin e menaxhimit te mjedisit” është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis, si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra, ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

2.3.6 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Lloji i makinerive/pajisjeve	Statusi	Sasia
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 10 ton	Ne pronesi ose me qira	2(dy) cope
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	Ne pronesi ose me qira	1(një) cope
3	Kamion me vinc 4x4	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
4	Kamion me kapacitet mbajtes 5-10 ton	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
5	Kamioncine me kapacitet mbajtes 1.5-3.5 ton	Ne pronesi ose me qira	1 (cope) cope
6	Fadrome me goma me kove para dhe mbrapa	Ne pronesi ose me qira	1 (cope) cope
7	Rimorkiator per transportin e makinerive	Ne pronesi ose me qira	1 (cope) cope
8	Autobetoniere	Ne pronesi ose me qira	1 (cope) cope
9	Autobot uji	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
10	Ekskavatore me zinxhire	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
11	Miniekskavatore me zinxhire	Ne pronesi ose me qira	5 (pesë) cope
12	Bobcat me goma	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
13	Betoniere kantieri	Ne pronesi ose me qira	3 (tre) cope
14	Vibrator Betoni	Ne pronesi ose me qira	2 (dy) cope
15	Makineri Prerese /Sharre asfalti	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
16	Sisitem well point per punime ne prezence uji	Ne pronesi ose me qira	2 (nje) cope
17	Matrapik	Ne pronesi ose me qira	2 (dy) cope
18	Saldatrice	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
19	Tokmak ngjeshes/Ngjeshes elektrik	Ne pronesi ose me qira	2 (nje) cope
20	Aparaturë për ngjitje tubacionesh me metodën “Elektro Fusion”	Ne pronesi ose me qira	2 (dy) cope
21	Motogjenerator	Ne pronesi ose me qira	2 (nje) cope

22	Pompe uji per testet e presionit	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
23	Aparat hekurkthyes	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
24	Pajisje per prerje tubash	Ne pronesi ose me qira	2 (nje) cope
25	Total Station + GPS te kalibruar	Ne pronesi ose me qira	1 (Nje) cope
26	Rrul cilinder cilinder	Ne pronesi ose me qira	2 (Dy) cope
27	Rrul gome gome	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
28	Armatura betoni	Ne pronesi ose me qira	150 m2
29	Asfaltoshtruese	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
30	Autobitumatrice	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
31	Sond çpimi horizontale	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
PAJISJE MBROJTESE			
Kokore minimumi		80 copë	
Jeleke fosforoshente minimumi		80 copë	
Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi		5 cope	
Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi		25 cope	
Prozhektorë ndriçimi natën minimumi		5 cope	
Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi		5 cope	

- a) Për makineri dhe mjete që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit: certifikatë pronësie, leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, siguracionin;
- b) Ndërsa për makineri dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- c) Për makineri dhe mjete që nuk shënohen në regjistra publikë (makineritë), kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse.
- d) Ndërsa për makineri dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur faturë zhdoganimi ose faturë tatimore blerje) dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- e) Për paisjet kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontratë blerje/faturë zhdoganimi/faturë tatimore blerje..

- f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilën makineri dhe mjete dhe paisje të deklaruar.
- g) Për makineritë dhe mjetet, fotoja duhet të ketë të dallueshme edhe targën e mjetit.
- h) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fitues.
- i) Shenim: Per mjetin "Rimorkiator per transportin e makinerive", ne rast se nga Operatori Ekonomik nuk disponohet dokumentacioni certifikate pronesisë / kontrate qeraje, nga autoriteti kontraktor do te pranohet edhe dokumenti kontrate huaperdorje.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), ku parashikohet: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" te pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...", sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit do t'i kërkojë ofertuesit te kualifikuar i pari nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit per disponimin e punonjesve, mjeteve/pajisjeve do te jete kusht s'kualifikimi.
- Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik"¹ në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burime të nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në nenin 39 "Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave" pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: "Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... **mjetet e pajisjet teknike**, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën."

- Nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t'u vendosur në DST. Vlerësohet se **operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë automjetet, mjetet dhe pajisjet e kërkuara me anë të cilave do të kryhet punimet (gërmime dheu dhe shkëmbi, prishje betoni, prerje asfalti, shtresa, shtrim asfalti, vendosje tubi, konstruksione etj.) dhe transporti i materialeve sipas zërave të punimeve të përcaktuara në preventivin e specifikimet teknike objekt kontrate**, ku sasia e tyre është kërkuar në përpjestim me natyrën e përmasat e këtyre punimeve, ku një operator ekonomik pa këto mjete e pajisje nuk mund t'i realizojë këto punimeve. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr.629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.
- Gjithashtu në zbatim të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”, **eshte kerkuar që operatorët ekonomikë duhet të disponojnë dhe pajisjet mbrojtëse për punonjësit të cilët do të angazhohen për kryerjen e punimeve objekt kontrate.**
- Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Eshte vlerësuar si e domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatëse në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi, me qëllim verifikimin dhe kontrollimin se vërtet këto mjete dhe pajisje disponohen nga operatorët ekonomikë, ka kërkuar që këto të fundit të deklarojnë vendndodhjen e tyre. Cdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të tyre.
- Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njësia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomike të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë bazuar sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjeti kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të

domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe paisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

- Persa me sipër, numri i mjeteve është përcaktuar në bazë të nevojës së objektit zhvillohet në një kohë të shkurtër pa cenuar grafikun e përcaktuar të punimeve dhe vëllimit të punës, objekti ka një shtrirje të konsiderueshme gjeografike në disa zona të ndryshme dhe me pas tek linja e shpërndarjes për në destinacion, prandaj do të punohet në disa fronte pune njëkohësisht për të kapur afatet e përcaktuara.
- Makinerite kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 10 ton dhe 20 ton, kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5 - 10 ton dhe kamioncinat janë kërkuar për transportin e materialeve që do të dalin gjatë germimeve sipas kërkesave në preventiv, ku ka germime në vëllime të mëdha në total dhe të germuara me krah rreth 200 m³ dhe me makineri total rreth 17100m³ si edhe transport dhe me auto në vëllime të konsiderueshme. Gjithashtu ky proces do të vazhdojë me sistemime, mbushje ngjeshje, drenazhime, largim të ujërave dhe transport të materialeve për shtresa rrugore, inerte, si dhe transportin e mbetjeve inerte të gjeneruara dhe depozitim të tyre në landfill.
- Makineritë betoniere të vogla, autobetoniere, vibrator betoni, armatura betoni, autobot uji, pompë uji janë kërkuar duke patur parasysh punimet në beton të cilat janë të konsiderueshme në preventiv.
- Mjeti Eskavator me zinxhirr për germim dhe 0,25m³ është kërkuar sipas kërkesave të preventivit.
- Minieskavator me zinxhirra janë kërkuar gjatë procesit të punës për zbatimin e punimeve të germimeve të dheut, nevojitet përdorimi i minimalisht një minieskavatori për një front pune dhe janë kërkuar disa duke qenë se do të punohet në disa fronte pune njëkohësisht për të kapur afatet e përcaktuara për objektin që do të ndërtohet. Referuar grafikut të punimeve brenda gjashtë muajve do të realizohen të gjitha punimet.
- Bobcat me gomë është kërkuar gjatë procesit të punës për zbatimin e punimeve të largimit dhe ngarkimit të dheut, nevojitet përdorimi i minimalisht një mjet I till.
- Është kërkuar pajisje Tok Mak Elektrik për ngjeshje dhe e cila shërben gjatë procesit të germimeve që përfshin preventivi i punimeve në të cilin është parashikuar mbushje, rrafshim, ngjeshje me tokmak elektrik në disa zera të tij. Gjithashtu referuar specifikimeve teknike ku përcaktohet: Mbushja me hedhje të dheut me makineri është rreptesisht e ndaluar. Hedhja e dheut, levizja dhe ngjeshja e tij do të bëhen vetëm me dorë. Për ngjeshje rekomandohen tokmake me buze të rrumbullakuara.
- Kamion me vinc 4x4 është kërkuar, lidhur me shtrirjen territoriale të vepres. Nisur nga gjurma e projektit lind nevoja e kamionit me vinc për transportimin e tubacioneve, rakorderive me peshe të konsiderueshme në ato pozicione rrugore që mund të jenë shumë të aksesueshme për kamionat me vetëshkarkim.
- Fadrome me gomë me kove para dhe mbrapa është kërkuar duke patur parasysh specifikimet teknike të publikuara në SPE ku parashikohet: Germimi dhe mbushja Germimi dhe mbushja e instalimeve të ujesjellesit do të realizohet **me fadrome** në akset ku kemi akses për të punuar makineria, në vendet ku nuk kemi akses germimi do të bëhet me krahe (me kazma etj.)
- Asfaltoshtuese, Autobotmatrice Rrul me cilindër cilindër, Rrul gome gome janë kërkuar duke patur

parasysh ne preventive jane parashikuar punime shtrese cakell,asfaltobetoni ,punimet e ngjeshjes së shtresave per ndertimin e rrjetit te ujesjellesit. Kerkesa per keto makineri te tilla eshte minimaliste.

- Rimorkiator per transportin e makinerive eshte kerkuar duke patur parasysh qe mjetet qe do te perdoren per kryerjen e punimeve do te duhen te cohen me rimorkiator pasi demtojne rrugen gjate procesit te transportit.
- Gjithashtu edhe Sistem Well Point eshte kerkuar ne referim te specifikimeve teknike te publikuara ne SPE: *“Largimi i ujerave nga punimet e germimit si pjese e punes ne zerat e germimit dhe jo me kosto plus per Punedhenesin, Sipermarresi do te ndertoje te gjitha drenazhimet dhe do te realizoje kullimin me kanale kulluese ,me pompim ose me kova si edhe te gjithë punet e tjera te nevojeshme per te mbajtur pjesen e germuar te paster nga ujerat e zeza dhe nga ujera te jashme gjate avancimit te punes dhe deri sa puna e perfunduar te jete e siguruar nga demtimet. Sipermarresi duhet te siguroje te gjitha pajisjet e pompimit per punimet e tharjes se ujit si edhe personelin operativ, energjine e te tjera, dhe te gjitha keto pa kosto shteseper Punedhenesin. I gjithë uji i pompuar ose i drenazhuar nga vepra duhet te hiqet ne nje menyre te aprovueshme prej Mbikqyresit te Punimeve. Duhet te meren masa paraprake te nevojeshme kunder permbytjeve. Mirembajtja e drenazheve Mbulimi do te behet ne menyre te tille qe te mos mbetet apo te akumulohet uje ne pjese e pambushura ose kanalet pjeserisht te mbushura. Materialet e depozituara ne kanalet e rrugeve ose ne rruge te tjera ujore qe nderpriten nga linja e kanaleve do te largohen menjehere pas perfundimit te procesit te mbulimit duke kthyer formen dhe permasat e kanaleve ne gjendjen e meparshme. Drenazhimet siperfaqsore nuk do te nderpriten per kohe te gjate nese nuk do te jete e nevojshme”*
- Pajisje per prerje tubash eshte kerkuar referuar specifikimeve teknike ku percaktohet:

“Tubat duhet te priten ne perputhje me rekomandimet e prodhuesit, me nje metode, e cila siguron nje profil te paster me kend te drejte, pa ndarje apo thyerje te trashesise se murit te tubave e cila shkakton deme minimale ne çdo shtrese mbrojtese. Kur eshte e nevojshme prerja, atehere skajet e tubit duhet te pastrohen me gerryes per te mos penguar saldimin..”

Ndersa mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, si dhe personelit jane kerkuar në zbatim të kerkesave te VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 ”Per miratimin e Rregullores per sigurine ne kantier”.

Njësia e prokurimit vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë objekt prokurimi.

2.3.7 Afati i kryerjes së punimeve:

Afati i kryerjes se punimeve eshte 12 (Dymbedhjet muaj) muaj sipas Grafikut te Punimeve te publikuar ne Sistemin Elektronik te Prokurimeve nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Operatori Ekonomik duhet te paraqese grafikun e punimeve ne perputhje me afatin kohor qe eshte lene nedispozicion per realizimin e kontrates.

Argumentimi: Kjo kerkese eshte bere ne baze te nenit 15 pika 3/a të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”* ku parashikohet: *“Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;”*

Njësia e prokurimit referuar të dhënave teknike dërguar nga sektori i projektimit ku parashikohej dhe afati i kryerjes së punimeve, vendosi që afati i punimeve të jete 12 muaj i vlerësuar si nje afat i

mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike: janë sipas projektit të zbatimit të hartuar nga projektuesi dhe marrë në dorëzim nga grupi i punës përkatës për marrjen në dorëzim të projektit me dokumentacionin teknik të tij , duke iu përmbajtur parashikimeve të nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Njësia e prokurimit po publikon specifikimet teknike për punimet objekt prokurimi

Shënim: Në të gjitha rastet në specifikime teknike ose preventiv ku mund të jenë përmendur markë specifike apo emërtim AK ka parashikuar se do të pranohen edhe ekuivalentët e tyre.

Shënim: Në të gjitha rastet ku në Dokumentat e tenderit, specifikimet teknike ose preventiv përmenden standarte ndërkombëtare Ak, ka parashikuar se do të pranohen edhe standartet kombëtare të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA).

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.

- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit.

Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë: Data: 11.05.2023 Ora 11:00 në mënyrë elektronike në www.app.gov.al .

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

